



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKËQYRËS

Nr. 6458/2 Prot

Tiranë, më 28/12/2021

Planveprimi për Vitin 2022, Agjencia e Trajtimit të Kredive

I nderuar Z. Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të ATK-së,

Të nderuar,

Në zbatim të Ligjit Nr.8894, Datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.33, datë 24.09.2010 të Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Agjencisë së Trajtimit të Kredive si dhe në vijim të procesit të raportimit, ju paraqes plan veprimin e Vitit 2022.

HYRJE

Misioni i Agjencisë së Trajtimit të Kredive është mbledhja e kredive të këqija të ish-bankave të nivelit të dytë me kapital shtetëror dhënë prej tyre deri në vitin 1998 në favor të buxhetit të shtetit. ATK ka një plan specifik dhe lidhur me detyrat operacionale, konkretisht angazhohen Sektori Juridik dhe Operacional si dhe Sektori i Menaxhimit të Riskut. Në bashkëpunim me specialistëve, kryhen shërbimet në terren, jo vetëm në kontaktimin e debitorëve, por edhe në inspektimin e kolateraleve të mara ose jo në pronësi.

Realizimi me sukses i misionit dhe pritshmëritë janë bazuar në pikat e plan veprimit si më poshtë:

- Trajtimi ligjor i dosjes së debitorëve
- Terreni
- Proceset gjyqësore
- Nxjerrja e pronave në ankand dhe Risku
- Marrëveshjet ndërinstitucionale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKËQYRËS

Bazuar në pikat sa më sipër, ky plan konkretizohet në saj të strategjisë operacionale të punës gjatë gjithë vitit 2022. Çdo fillimjavë dhe çdo fundjavë Drejtoria e ATK-së kryen mbledhje dhe analizon raportin pritshmëri-realizim, si dhe analiza të detajuara në drejtori për 3-mujorin, 6-mujorin, 9-mujorin dhe në 1 vit. Do të vazhdojnë masat administrative për të përmirësuar punën dhe për të zgjidhur problematikat e krijuara, por edhe për të zbatuar detyrat dhe realizimin me sukses të objektivave që ka institucioni, sipas një strategjie të Drejtorisë së ATK-së si më poshtë:

1. Trajtimi ligjor i dosjes së debitorëve

Prioritet do të ketë lidhur me saktësimin dhe grupimin e portofolit të debitorëve, jo vetëm sipas bankave kredidhënëse dhe madhësisë së detyrimit, por edhe sipas objektit të kredisë, llojit të kolateralit, ndarjes territoriale (komunave dhe bashkive), etj., duke i renditur në mënyrë piramidale nga më i madhi tek më i vogli. Bie në sy fakti se numrin më të madh të debitorëve e zënë ata me detyrim principal të transferuar deri në 500 mijë lekë, të cilët në numër arrijnë në rreth 7560 persona ose rreth 62% e numrit të debitorëve të mbetur për trajtim. **Synohet që në periudhën Janar - Mars 2022 të kenë prioritet këto raste, pasi edhe arkëtimet janë më të realizueshme duke qenë se nuk janë shuma të konsiderueshme.**

Këto kredi janë dhënë përpara vitit 1997 dhe dokumentacioni në banka të disa qyteteve të Shqipërisë u dogj dhe shkatërrua. E vetmja e dhënë për këto debi është proces-verbali i transferimit. Në bazë të Nenit 10 të Ligjit, Nr.8894, Datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Kredive” i ndryshuar “Për huatë e transferuara në Agjencinë e Trajtimit të Kredive pa dokumentacionin ligjor që vërteton marrjen e kredisë, procesverbali i transferimit të detyrimit kontabël të këtyre huave përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga përmbartuesi gjyqësor”. Urdhërat e Ekzekutimit që kanë dalë bazuar në proces-verbal është shpallur i pavlefshëm ekzekutimi nga gjykata, sepse nuk mund të provohet ekzistenca e debisë me prova shkresore nga ana e Agjencisë në lidhje me kredimarrësin sepse Kontrata individuale e Huasë (titulli i detyrimit) nuk gjendet. Ka nisur një proces intensiv nga Juristët e zonave për të zgjidhur problematikat ligjore të mbartura, në plotësimin e dokumentacionit, nxjerrjen e dublikatit të Urdhër Ekzekutimit.

Pranë shërbimit përmbartimor privat janë për ekzekutim të detyrueshëm rreth 1700 dosje dhe pranë atij Shtetëror rreth 80 dosje. **Pritet që të dërgohen në ekzekutim afro 400-500 dosje në Zp Shtet ose Privat. Ky proces pritet që të vijojë edhe në periudhën Janar-Qershor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKËQYRËS

2022. Duke pasur një principal të konsiderueshëm në ekzekutim, pritshmëritë që kemi nga dosjet janë të larta në realizimin e targetit për Vitin në vijim dhe jo vetëm, në saj edhe të një bashkëpunimi dhe ndjekjes së procedurave dhe kërkimit të informacionit nga ana e ATK-së si palë kreditore.

2. Negociatat me debitorët në terren

Synohet që edhe gjatë Vitit 2022, do të vazhdohet me takime në terren të debitorëve, trajtimin e problematikave sipas rasteve konkrete, saktësimet e adresave për gjetjen e debitorëve me principal të ulët, të cilët për marrjen e kredisë nuk kanë lënë kolateral si garanci dhe gjetja e vendbanimit aktual të tyre rezulton më e vështirë. Synimi është që nga Sektori Juridik dhe Operacional, në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Riskut dhe ndihmën e Sektorit të Financës në nxjerrjen e detyrimeve, bazuar edhe në strategjitë 3-mujore të ATK-së synohet që të takohen dhe negociohet me 300 debitorë që janë në trajtim me detyrim të hapur. **Kjo në saj edhe të shërbimeve në çdo qark nga Specialistët që mbulojnë zonat, ku synohet që të realizohet 55%-65% e planit mujor, por edhe në 3-mujor.**

3. Proceset gjyqësore

Problematikë mbetet rritja e numrit të proceseve gjyqësore. Proceset gjyqësore janë me padi të ngritura për “pavlefshmëri titulli”, për pretendim të plotësimit të afatit të parashkrimit, për shkak se janë kredi janë dhënë para më shumë se 25 viteve. Amortizimi i portofolit ka bërë që shumë debitorë t’u drejtohen gjykatave me kërkesë-padi, me objekt kryesisht “Pavlefshmëri titulli dhe kundërshtim apo pezullim të veprimeve përmbartimore”. Proceset gjyqësore ndiqen me prioritet nga ana e institucionit, ku përfaqësohemi në çdo seancë, me synim rikuperimin e debisë.

Nëse do t’i referohemi proceseve gjyqësore, debitorët me principal të lartë të transferuar janë më të prirur për të ngritur padi për “pavlefshmëri titulli” në krahasim me debitorët me principal të ulët. Në bazë të statistikave, nga ana e Sektorit Juridik dhe Operacional ndiqen gjatë një vitit rreth 200 seanca gjyqësore, që i përkasin 40 proceseve, të reja apo të mbartura dhe të kthyer për rigjykim nga gjykatat e shkallëve më të larta. **Në bazë të pritshmërive, për periudhën Janar-Dhjetor 2022 synohet që të rikuperohen të paktën 20 procese dhe këta debitorë të paguajnë shumat e detyrimit në ATK.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKËQYRËS

4. Sektori i Riskut dhe Ankandet

Agjencia e Trajtimit të Kredive aktualisht ka në pronësi të saj 79 prona, të cilat janë marrë në pronësi me një vlerë prej 175,128,646 milion lekë. Vlen për t'u përmendur se që prej Vitit 2019, si pjesë e strukturës së ATK është krijuar edhe Sektori i Menaxhimit të Riskut, për të vlerësuar mundësinë e vjeljes së detyrimit për secilin prej debitorëve, duke u bazuar në evidentimin fizik dhe analizën ligjore të dosjeve nga Sektori Juridik dhe Operacional. Sektori i Menaxhimit të Riskut do të mari në analizë edhe kolaterat në pronësi të ATK-së për të parë mundësinë e ankandit të pronave që janë me përfitueshmëri nga ana jonë.

Puna e Sektorit do të fokusohet në plane afatshkurtra për realizimin e planeve mujore të arkëtimeve, por do të shihen edhe planet afatgjata, duke krijuar regjistrin pasiv, i cili do të përfshijë debitorë ndaj të cilëve ATK-ja ka ndjekur çdo proces dhe i ka etiketuar të tillë për faktin që nuk mundet të ketë likuidim detyrimi.

Sektori po punon për plotësimin e dokumentacionit ligjor për disa prona, të cilat kanë kaluar me vendim nga përmbaruesit në pronësi të ATK-së, duke bërë aplikimet në ASHK përkatëse për t'u pajisur me certifikatë pronësie. Gjithashtu kanë filluar procedurat për nxjerrjen në ankand të pronave me qëllim rritjen e arkëtimeve. **Gjatë vitit të kaluar janë evidentuar pronat dhe në Vitin 2022, sipas një trajtimi më të detajuar, pritet të sjellë benefite në targetin dhe strategjinë për realizimin e tij dhe synohet që 20-30% e planit vjetor të realizohet nga shitja e pronave të ATK-së.**

5. Marrëveshjet ndër-institucionale

Gjatë Vitit 2022, shpresojmë që të kemi një bashkëpunim më efikas me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjëndjes Civile, për saktësimin e adresave të debitorëve dhe në funksion të evidentimit të debitorëve synohet që të vijoje bashkëpunimi me 61 njësitë e qeverisjes vendore. Janë marrë kontaktet e nevojshme me administratorët e këtyre njësiteve. Në saj edhe të këtij bashkëpunimit, institucioni pritet që të ketë sukses duke bërë të mundur kontaktin e drejtpërdrejtë me debitorët.

Intensifikimi i marrëdhënieve ndër-institucionale pritet të japë efekte pozitive në realizimin e objektivit kryesor që ka Agjencia, mbledhjen e borxhit dhe arritjen e targetit vjetor. Për këtë qëllim do të vazhdohet me negociatat për rifreskimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me ASHK-në, lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi me RBS si dhe me institucione të tjera.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE
KËSHILLI MBIKËQYRËS

Në funksion të realizimit të tyre do të krijojmë mundësitë për marrëveshje bashkëpunimi me OSSHE dhe Postën Shqiptare për saktësimin e adresave dhe evidentimin e tyre në terren. Një marrëveshje e rëndësishme do të ishte edhe ajo me AKEP për numrat e kontaktit të debitorëve.

Konkluzione: Sipas vlerësimit tonë fokusi i punës së Agjencisë së Trajtimit të Kredive duhet të jetë identifikimi i debitorit dhe kontaktimi i tij, por edhe puna për analizën reale të borxhit të mbetur si dhe trajtimi ligjor, deri në vjeljen e plotë të detyrimit. Nëpërmjet organizimit të brendshëm të punës sistematike dhe vizionare dhe forcimit të kërkesës së llogarisë, frymës së bashkëpunimit mes sektorëve do të krijojmë bindjen, se informacioni i mirë dhe kontrolli përbëjnë çelësin e suksesit në të ardhmen. Vetëm në këtë këndvështrim tërësor, Plani strategjik i ATK-së mund të jap efektin e duhur për drejtimin e inistucionit në vazhdim dhe realizimin e funksionit me sukses.

Duke ju falënderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

